

**Akt themelimi**  
**I shoqërise me përgjegjësi të kufizuar**  
**"XHEBEXHIU CONSTRUCTION" shpk**

Ne bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 'Për qendrën kombëtare të biznesit ' sot më datë 02/10/2024, unë i nënshkruari:

1-Erion Xhebexhiu, shtetas shqiptar, i biri i Kristo, lindur më 26/09/1998 në Lushnje dhe banues në Lagja « Kongresi i Lushnjes », Lushnje, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039400398, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i vetëm** :

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, dhe në kushtet e përcaktuara në këtë Statut.

Aktiviteti i kësaj shoqërie do të rregullohet nga statuti i saj, i cili është pjesë perberese e këtij akti themelimi dhe i bashkangjitet si shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i shoqërisë është " **XHEBEXHIU CONSTRUCTION** " shpk

**Neni 2**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën :

Lushnje, Lagja « Kongresi i Lushnjes », banese private me nr. 16/27, e cila ndodhet në Z.Kadastrale 8571.

Shoqëria mund të krijojë degë, zyrë, filiale dhe të zhvilloj aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 3**

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar të Republikës së Shqipërisë.



Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 4

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

Ndërtime banesa dhe rikonstruksione të ndryshme banesash, pallate dhe hotele. Karpentier. Përpunim dhe lidhje hekuri . Suvatime të brendshme dhe të jashtme. Lyerje të brendshme dhe të jashtme , shtrim pllakash, mermer dhe parkete . Punime çatie me tjegulla dhe druri , punime elektrike dhe hidraulike . Punime murature , gërmime dheu , hedhje betoni , hidroizolime . Dekore fasadash dhe veshje të ndryshme fasadash. Punime duroalumini. Punime të ndryshme ndërtimi. Ndërtime struktura parafabrikate prej betonarme, druri dhe metalike. Gërmim dheu, pilota, diafragma, ankorime, mure mbajtëse, stabilizim skarpate dhe përforcim dhera. Punime për prishjen e ndërtimeve. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave me mjetet e vetë shoqërisë, për llogari të saj, të të tretëve dhe me qera. Transport të mallrave me mjete jashtë norme dhe shoqërim teknik të tyre. Import-export dhe tregëtim me shumicë dhe/ose pakicë të pajisjeve dhe materialeve të ndërtimit, industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, hidraulike, elektrike, elektronike, drusore, pjesë këmbimi të reja dhe përdorura, brenda dhe jashtë vendit.

#### Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 ( njëmilion ) lekë , i cili ndahet në 1 kuotë, e cila zotërohet nga ortaku i vetëm e saj. Kapitali themeltar është i nënshkruar nga ortaku i vetëm e saj.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakut të vetëm e saj.

Ortaku i Shoqërisë është si vijon :

**1:** Erion Xhebexhiu, shtetas shqiptar , i biri i Kristo, lindur më 26/09/1998 në Lushnje dhe banues në Lagjja « Kongresi i Lushnjes », Lushnje , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039400398, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i vetëm** »)

Ortaku i vetëm zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 1.000.000 ( njëmilion ) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblesë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.

## Neni 6

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet vendimeve të ortakëve të shoqërisë. Administrator i Shoqërisë do të jetë: Erion Xhebexhiu, shtetas shqiptar, i biri i Kristo, lindur më 26/09/1998 në Lushnje dhe banues në Lagjja « Kongresi i Lushnjes », Lushnje, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039400398, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar - i cili do të emërohet për një mandat fillestar 5 (pesë) vjeçar me të drejtë ri-emërimi. Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marreveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblese se Ortakëve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore hartohen nga Administratori.

## Neni 7

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq kohë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shpërblimin përkatës, kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

## Neni 8

Cështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë akt themelimi, do të referohen ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe legjisllacionit shqiptar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

## Neni 9

Akti i themelimit është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë.

## ORTAKU THEMELUES

**Erion Xhebexhiu**

Erion Xhebexhiu